

KUVENDI

NR 647 DATE 25.02.21



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

GRUPI PARLAMENTAR I PARTSË SOCIALISTE

Nr. \_\_\_\_ Prot .

Tiranë, më \_\_\_\_ .2021

**Lënda :** Depozitim projektligji

**Drejtuar:**

**Z. GRAMOZ RUÇI  
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

I nderuar Z.Kryetar,

Bazuar në nenin 81 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes projektligjin "DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8116, DATË 29.3.1996, "KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR".

**DEPUTETI PROPOZUES**

*Alket Hyseni*  
2021

Alket Hyseni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_ / 2021

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8116, DATË 29.3.1996, "KODI I  
PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË",  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja "d" dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 35 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e katërt, fjalia e dytë, ndryshohet si më poshtë:

"Gjykata e apelit shqyrton me një gjyqtar të vetëm ankimet kundër vendimeve për paditë me vlerë deri në njëzet fishin e pagës minimale në shkallë vendi, që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore, ankimin e veçantë kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, ankimet e veçanta kundër vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kundërshtimin e primeve të përbaruesit gjyqësor, si dhe rastet e tjera të parashikuara në këtë Kod."

2. Në paragrafin e fundit, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia:

“Për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë gjykon në kolegji me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë.”.

## **Neni 2**

Në nenin 59, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kur gjykata vendos nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, lejohet rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë, ndërsa kur vendos që çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, kundër vendimit lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar ose jopërfundimtar.”.

## **Neni 3**

Neni 62 ndryshohet si më poshtë:

“Kundër vendimit të gjykatës mbi kompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjes, lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar ose jopërfundimtar.”.

## **Neni 4**

Neni 63 shfuqizohet.

## **Neni 5**

1. Paragrafi i dytë i nenit 64 ndryshohet si më poshtë”

“Konfliktet për kompetencë midis gjykatave nuk lejohen, por gjykata ka të drejtë t'i parashtrijë qëndrimin e saj Gjykatës së Lartë, e cila vendos për rregullimin e kompetencës në dhomë këshillimi, me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë.

2. Pas paragrafit të dytë të nenit 64, shtohen paragrafët e tretë dhe të katërt, me përmbajtjen si vijon:

“Gjykata e Lartë shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se tridhjetë ditë nga momenti i depozitimit të parashtrësës.

Gjykata e Lartë në vendimin e saj për rregullimin e kompetencës jep udhëzimet e nevojshme për procesin gjyqësor të zhvilluar dhe për vazhdimin e tij nga gjykata që deklarohet kompetente.”.

## **Neni 6**

Në nenin 75 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i dytë, ndryshohet si më poshtë:

“Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të gjykatës së apelit vendos një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate, i ndryshëm nga gjyqtarët e trupit gjykues të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.”.

2. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë vendos një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate, i ndryshëm nga gjyqtarët e kolegjit të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.”.

## **Neni 7**

Në nenin 162/a bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, togfjalëshi “deri në 150 000 lekë” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në njëzetfishin e pagës minimale, në shkallë vendi”.

2. Pika 4 ndryshon me këtë përmbajtje: “4. Në rast se vlera e padisë është më e vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi, dhe vlera e kundërpadisë tejkalon njëzetfishin e pagës minimale, në shkallë vendi, gjykimi zhvillohet sipas dispozitave të përgjithshme për gjykimin e zakonshëm.”.

## **Neni 8**

Në nenin 236/a, fjalia e parë, togfjalëshi “deri në 150 000 lekë” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në njëzetfishin e pagës minimale, në shkallë vendi”.

## **Neni 9**

Në nenin 285/a, pika 1, togfjalëshi “deri në 150 000 lekë” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në njëzetfishin e pagës minimale, në shkallë vendi”.

## **Neni 10**

Në nenin 310, paragrafi i dytë, pika 3, fjalia e dytë, togfjalëshi “deri në 150 000 lekë” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në njëzetfishin e pagës minimale, në shkallë vendi”.

## **Neni 11**

Në nenin 443, paragrafi i katërt, pas togfjalëshit “Afati i ankimeve” shtohet togfjalëshi “dhe rekurseve”.

#### **Neni 12**

Në nenin 460 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 5, fjalia e parë, pas togfjalëshit “orën e gjykimit” shtohet togfjalëshi “si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen”.

2. Pas fjalisë së fundit të pikës 5, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rast se përbërja e trupit gjykues nuk është njoftuar sipas rregullave të përcaktuara në këtë pikë, palët mund të kërkojnë shtyrjen e gjykimit përveç rasteve kur marrin pjesë në gjykim dhe nuk kërkojnë përjashtimin e gjyqtarëve”.

3. Pas pikës 5, shtohet pika 5/1 me përmbajtjen si vijon:

“Palët kanë të drejtë që deri 5 ditë para shqyrtimit të çështjes të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim.”

#### **Neni 13**

Në nenin 465/a, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, togfjalëshi “Kryetari i trupit gjykues” zëvendësohet me fjalën “Relatori”.

2. Pika 3 ndryshon me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“3. Gjykata, në dhomë këshillimi vendos kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm:

a) për të vlerësuar nëse duhen marrë apo pranuar fakte ose prova të reja, sipas nenit 465 të këtij Kodi, ose:

b) kur vë në diskutim çështje të faktit ose të ligjit, për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre.”

#### **Neni 14**

Në nenin 466, pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kundër vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes lejohet rekurs i veçantë.”

#### **Neni 15**

Në nenin 467, pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kundër vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, lejohet rekurs i veçantë.”

#### **Neni 16**

Në nenin 469, paragrafi i dytë shfuqizohet.

#### **Neni 17**

Në nenin 470 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, pas togfjalëshit “në gjykatën e apelit” shtohen fjalët “ose rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë”.
2. Në pikën 3, pas fjalës “Ankimet” shtohen togfjalëshi “ose rekursët”.

#### **Neni 18**

Pas nenit 471 shtohet neni 471/a me këtë përmbajtje:

“Neni 471/a

#### **Shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve jopërfundimtare**

Ankimet dhe rekursët e veçanta kundër vendimeve jopërfundimtare shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë.”.

#### **Neni 19**

Në nenin 473/a, pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe që palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre mbi çështjet e ligjit. Njoftimi në këto raste kryhet sipas rregullave të përgjithshme.”.

#### **Neni 20**

Neni 474 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Rekursi dhe të gjitha kërkesat e tjera që paraqiten në Gjykatën e Lartë nënshkruhen nga avokati që e përfaqëson palën dhe nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit.”.

## Neni 21

Në nenin 475 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, shkronja "ç" ndryshohet si më poshtë:

"ç) shkaqet për të cilat kundërshtohet vendimi si dhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë shkaqe për rekurs sipas parashikimeve të nenit 472 të këtij Kodi;"

2. Pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

"Rekursi mund të paraqitet sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Gjykatës së Lartë.".

## Neni 22

Neni 476 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

### “Neni 476 Depozitimi i rekursit

1. Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, në afatin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve.

2. Së bashku me rekursin duhet të depozitohet:

a) kopja e vërtetuar e vendimit të kundërshtuar dhe kur është rasti edhe e njoftimit kur ky është bërë;

b) prokura e posaçme;

c) aktet dhe dokumentet mbi të cilat është bazuar rekursi, në atë masë sa janë palët.

3. Kur rekursi nuk plotëson kushtet e parashikuara në pikën 1 dhe 2, të këtij neni, nuk është nënshkruar sipas nenit 474 ose nuk është paraqitur në përputhje me paragrafin e parë të nenit 475 të këtij Kodi, relatori që ka dhënë vendimin ose gjyqtari i vetëm njofton palën për të plotësuar të metat e rekursit brenda 5 ditëve. Në këtë rast, shqyrtimi i rekursit bëhet në dhomë këshillimi.

4. Kur ankuesi nuk plotëson ose korrigjon të metat brenda afatit, rekursi quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet palës së bashku me aktet e tjera të paraqitura prej tij. Kundër vendimit të gjyqtarit për kthimin e rekursit mund të bëhet rekurs i veçantë.

5. Kur të metat e rekursit janë plotësuar në afatin caktuar, konsiderohet i regjistruar në datën e depozitimit në gjykatë.

6. Sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, pas shqyrtimit nga gjyqtari nëse rekursi është plotësuar në afat, përcjell dosjen së bashku me dokumentet në sekretarinë e Gjykatës së Lartë.

7. Kur të metat e rekursit nuk janë konstatuar nga gjykata më e ulët, relatori i çështjes në Gjykatën e Lartë me vendim njofton palën për të plotësuar të metat brenda 5 (pesë) ditëve. Kur të metat e rekursit nuk plotësohen brenda afatit, relatori, në dhomë këshillimi, vendos kthimin e rekursit. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.”.

## Neni 23

Neni 481 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 481

### **Gjykimi për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore**

1. Kolegji Civil, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njëzuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore. Nisja e procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore mund të vendoset edhe nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

2. Vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Civil ose i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore përcakton çështjet e shtruara për njësim ose praktikën gjyqësore të njëzuar që duhet ndryshuar. Vendimi publikohet menjëherë pas arsyetimit, në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

3. Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegji Civil me trup gjykues prej 5 gjyqtarësh, në të cilën marrin pjesë trupi gjykues që po gjykon rekursin dhe dy gjyqtarë të tjerë të Kolegjit, të caktuar me short.

4. Gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njëzuar bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, si kryesues i Kolegjeve të Bashkuara cakton datën dhe orën e gjykimit të çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

5. Data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës.

6. Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë ndryshimin e çështjeve të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Ky vendim i ndërmjetëm publikohet në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

7. Për shkak të interesit që paraqet njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore, në këto gjykime, kur është rasti, Gjykata e Lartë mund të kërkojë mendimin me shkrim nga Avokatura e Shtetit, si dhe nga persona juridikë publikë ose privatë që çmohet se kanë njohuri të posaçme mbi çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Gjykata e Lartë,



në kërkesën për paraqitjen e mendimit me shkrim cakton një afat brenda të cilit mund të paraqitet mendimi, i cili në çdo rast nuk mund të jetë më i vogël se 14 ditë. Mendimet me shkrim nuk janë detyruese dhe publikohen në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

8. Vendimi i Kolegjit Civil dhe Kolegjeve të Bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.

## **Neni 24**

Neni 482 ndryshohet me këtë përmbajtje:

### **“Neni 482 Shqyrtimi i çështjes**

1. Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.

2. Gjyqtari relator i caktuar me short vendos datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në përputhje me rregullat e planifikimit të gjykimin të parashikuara në ligj.

3. Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën, orën si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimin.

4. Palët mund t'i kërkojnë me shkrim relatorit përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

5. Gjyqtari relator paraqet relacionin, duke pasqyruar në të, veç të tjerave, arsyet e përshpejtimin të çështjes, nëse ka, përmbajtjen e vendimit të ankimuar, pretendimet dhe shkaqet e ngritura në rekurs, prapësimet e paraqitura në kundërrekurs, shqyrtimin e fakteve që kanë rëndësi për marrjen e vendimit dhe propozimin e tij për zgjidhjen ligjore të çështjes.

6. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.”.

## **Neni 25**

Pas nenit 482 shtohet neni 482/a me këtë përmbajtje:

### **“Neni 482/a Kalimi i çështjes në seancë gjyqësore**

1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se:

a) çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës, për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;

b) vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Civil thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, sipas shkronjave “b” dhe “c” të nenit 472, si dhe paragrafit të dytë të nenit 473/a të këtij Kodi.

2. Vendimi i mësipërm, si dhe data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, të paktën 15 ditë para datës së zhvillimit të seancës.”.

### **Neni 26**

Pas nenit 483 shtohet neni 483/a me këtë përmbajtje:

"Neni 483/a

#### **Procedimet paragjykimore**

1. Nëse Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të çështjes, në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore, vendosin t'i drejtohen Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut ose gjykatave të tjera ndërkombëtare, sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë vendosin pezullimin e shqyrtimit të çështjes.

2. Vendimi i pezullimit zgjat deri në marrjen e vendimit nga gjykata ndërkombëtare. Vendimi i gjykatës ndërkombëtare u njoftohet palëve bashkë me datën e seancës.”

### **Neni 27**

Neni 485 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 485

#### **Vendimet e Gjykatës së Lartë**

1. Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin:

a) mospranimin e rekursit, në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i këtij Kodi;

b) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës të shkallës së parë;

c) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues;

ç) prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës të shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykata e apelit;

d) prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes;

dh) ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe të vendimit të gjykatës së apelit, dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes, kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes;

e) lënien në fuqi të vendimit të apelit.

2. Në rastet kur Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, në vendim gjykata formulon edhe rregullin e së drejtës për çdo çështje të shtruar për zgjidhje në vendimin e ndërmjetëm të marrë gjatë gjykimit të çështjes. Në këtë rast, vendimi botohet në Fletoren Zyrtare.”.

#### **Neni 28**

Pas nenit 485/a shtohet neni 485/b me këtë përmbajtje:

“Neni 485/b

#### **Njoftimi i vendimit të Gjykatës së Lartë**

Sekretaria gjyqësore njofton vendimet e Gjykatës së Lartë sipas nenit 316 të këtij Kodi.”.

#### **Neni 29**

Neni 490 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 490

#### **Heqja dorë nga rekursi**

1. Pala mund të heqë dorë nga rekursi derisa Kolegji Civil apo Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk janë tërhequr për vendim. Heqja dorë bëhet me shkrim, e nënshkruar nga vetë pala ose avokati i saj, i pajisur me prokurë për këtë qëllim.

2. Akti i heqjes dorë u njoftohet palëve. Kur hiqet dorë nga rekursi dhe në gjykim kanë marrë pjesë të gjitha palët ose përfaqësuesit e tyre, nuk ka vend për shpallje të veçantë të vendimit të mospranimit të rekursit, por palëve u vihet në dispozicion vendimi.”.

### **Neni 30**

Në nenin 493 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi i dytë dhe i tretë me përmbajtjen si më poshtë:

“Gjykata e Lartë, kur dërgon çështjen për rigjykim, në vendim përcakton se cila pjesë e vendimit ose gjykimit të faktit prishet dhe për cilën pjesë të mosmarrëveshjes duhet të zhvillohet rigjykimi.

Rigjykimi i çështjes pas prishjes së vendimit kufizohet vetëm në shkaqet e prishjes së vendimit. Pjesët e pacenuara të vendimit apo gjykimit nga gjykata më e lartë nuk rishqyrtohen.”.

### **Neni 31**

Në nenin 610, pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje:

“Ankimet kundër veprimeve ose refuzimit të përmbartuesit gjyqësor, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar i vetëm, gjatë gjithë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, kur veprimet ose refuzimi i përmbartuesit gjyqësor lidhet me të njëjtin titull ekzekutiv, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.”

### **Neni 32**

#### **Dispozitë kalimtare**

1. Përbërja e trupave gjykues si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera

2. Rekursitet e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshëm nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.”.

### **Neni 33**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**GRAMOZ RUÇI**